

VENDIM
Nr. 396, datë 18.6.2014

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN NR. 145, DATË 20.2.2013, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE,
“PËR PJESËMARRJEN E FORCAVE TË ARMATOSURA TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË, ME
PËRFAQËSUES NË SHTABIN “EUFOR”, NË KUADËR TË OPERACIONIT USHTARAK
“ALTHEA”, TË BASHKIMIT EVROPIAN, NË BOSNJË-HERCEGOVINË”

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 6, pika 5, e 7, të ligjit nr. 9363, datë 24.3.2005, “Për mënyrën dhe procedurat e vendosjes dhe të kalimit të forcave ushtarake të huaja në territorin e Republikës së Shqipërisë, si dhe për dërgimin e forcave ushtarake shqiptare jashtë vendit”, të ndryshuar, dhe të nenit 14, pikat 6 e 11, të ligjit nr. 8671, datë 26.10.2000, “Për pushtetet dhe autoritetet e komandimit e të drejtimit strategjik të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Mbrojtjes, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shkronja “a”, e pikës 4, të vendimit nr. 145, datë 20.2.2013, të Këshillit të Ministrave, ndryshohet si më poshtë vijon:

“a) dieta për ditët e qëndrimit, në masën 6 000 (gjashtë mijë) lekë në ditë, përveç pagës mujore;”.

2. Ngarkohet ministri i Mbrojtjes për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama